

Pogradec me, datë 27.10.2022

Statuti dhe akt-themelimi i Shoqerise

“LIONEL 2022“ SH.P.K

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “**LIONEL 2022 “ SH.P.K**

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria “**LIONEL 2022“ SH.P.K**, eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me përgjegjesi te kufizuar (me poshtë e quajtur “Shoqeria”).

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare e Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimitarisë së saj.

Shoqëria “**LIONEL 2022“ SH.P.K**, eshte një e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Pogradec, me adresë **POGRADEC Rruga Reshit Çollaku, Godina 4/10, Hyrja 2, Zona Kadastrale 8582**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërise, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti

Shoqeria do te ushtroje aktivitet privat ne fushen:

Import-eksport dhe tregti me shumice e pakice te artikujve te ndryshem ushqimore, vere etj.



Neni 5
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per një periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë, i perbere nga 1 kuote
Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga ortaku i shoqerise perkatesisht :

Maradon Palla me Nr.ID I21116053Q, zoterues i 1 kuote, me vlore te pergjithshme 100000.000 leke, qe perbejne 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.
Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit te një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpëra datës së mbledhjes së asamblesë të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Neni 8
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare e Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Biznesit" i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 9

Organ Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligji.


Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



Neni 10

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11

Kuorumi

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

b) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, miratimin e bilancit, kontrollin e llogarive, miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë, riorganizimin, bashkimin ose ndarjen e shoqerise, shnderimin ne një forme tjeter, transferimin e kuotave, emerimin e eksperteve dhe likuidatoreve dhe prishjen e shoqërisë, zhvillon mbledhje te jashtezakonshme, te cilat jane te vlefshme, kur ne te jane te pranishem ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se gjysmen e numrit total te kuotave te kapitalit te shoqerise te cilet votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligjit 9901 date 14.04.2008 dhe merren vendime te vlefshme me votimin pro te ortakeve pjesemarres.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesemarrës, kur ne te marrin pjesë ortakët me të drejtë vote te cilet zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrijen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 13 Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga një administrator .

*Administratori i shoqerise eshte **Maradona Palla** mbajtes i kartes se identitetit **ID 121116053Q** i cili do te ushtroje detyrat e administrimit sipas statutit dhe ligjit per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riparterite.*

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratoren në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori/et shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare te Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe një person jashtë ortakerise

Neni 14 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqerinë tregtare;

c) kujdeset përmbraktuar për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmiratuese, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmiratues për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmiratues së shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston reziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përmiratues së shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqerinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshihet këtu autoritetet gjyqësore të gjitha

shkallev. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si perpara Bankave te te gjitha nivele, per te kryer derdhje, terheqje, transferta, etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave, Zyrave te Qeverisjes Vendore, Zyrave te Punës, Autoritetet e Doganore, etj, në të gjitha rrëthanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 15

Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

c) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen

e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuar. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.



Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori/et.

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 18

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithvejetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Neni 19

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondevë ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi te ortakeve.

Neni 20

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- d) me vendim të gjykates;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të

shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument tē nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave tē likuidimit nē gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim tē rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim pér emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, pér tē caktuar një likuidues.

Neni 21

Likuiduesi merr përsipër tē drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit tē tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvçese kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht tē drejtat e detyrimet sipas këtij ligji.

Likuiduesit mund tē autorizojnë njërin prej tyre tē kryejë veprime tē një kategorie tē posaçme.

Kufizimet e tagrave tē likuiduesve u kundrejtohen tē tretëve, nē përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit/eve.

Neni 22

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve tē shoqërisë, mbledhja e kredive tē paarkëtuara dhe e kontributeve tē pashlyera, shitja e pasurive tē shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 tē Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund tē kryejë edhe veprime tē reja tregtare, pér mbylljen e një veprimi tē papërfunduar.

3. Nëse, nē bazë tē padive tē ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 tē ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme pér pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave tē falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc tē gjendjes së shoqërisë nē çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar nē çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore tē shoqërisë. Bilancet nē shoqerinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa nē shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi tē kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 23

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve tē mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare tē Biznesit pér përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, nē përputhje me seksionin V tē ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Pér Qendrën Kombëtare tē Biznesit" i ndryshuar.

Neni 24
Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 25
Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblese se Ortakeve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008..

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasojë:

a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja përmarrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;

b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 26
Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 27
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.



Neni 28

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptar.


Neni 29

Dispozita perfundim

Ky statut u redaktua ne 2 ekzemplarë me permajtje dhe vlera te njejtave juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua ne parim nen për nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare "**LIONEL 2022**" SH.P.K nenshkruehet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

O R T A K U

Maradon Palla

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Maradon Palla".